



Gruaja
sipas
Imam Khomeinit

Tiranë, 2018

Titulli: Gruaja sipas Imam Khomeinit

E përktheu: **Vullnet Merja**

Recensues: **Sabrie Feza**

E redaktoi: **Liseda Ramaj**

E korrektoi: **Vjollca Karaj**

Përgatiti për shtyp & Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

Nëse popujt do të privoheshin nga gratë trimëresha dhe të kulturuarat, atëherë ata do të shkonin drejt shkatërrimit.¹

¹ Në një bisedë nga tubimi i grave në Kum, 6.3.1979.

Parathënie

Çështja e gruas është një çështje aq e vjetër sa edhe vetë njeriu në sipërfaqen e tokës. Situatat e gruas ndryshojnë sipas përmbysjes së shoqërive njerëzore. Pozita e saj herë është ngritur lart nëpërmjet lartësimit të shpirtit të saj, duke kapërcyer kështu vlerat e lavdisë dhe të përsosjes, e herë të tjera ka rënë në baltën e shoqërive të ndryshme, të cilat e kanë lënë në harresë anën e saj njerëzore, për ta shndërruar atë thjesht në një statujë me pamje të bukur, të fiksuar në një cep të rrugës, apo duke e shfaqur në ndonjë ekran televizioni.

Allahu i Lartësuar ka dashur që femra të jetë një individ me vlera, kurse njerëzit injorantë kanë dashur që ajo të jetë një statujë. Një statujë pa shpirt, pa një domethënie dhe pa përmbajtje.

Por cili është ai që i ka dhënë të drejtën gruas dhe cili i ka bërë padrejtësi?

Cili e ka ngritur atë lart në pedestal, drejt majave të përsosjes dhe nderimit, dhe cili e zbriti atë poshtë, e zbrazti nga çdo kuptim dhe nxorri prej saj çdo lloj force?

Ku është forca e gruas dhe si bëhet e përsosur ajo?

Ky libërth i vogël pasqyron mendimin e Imam Khomeinit. Ai u përpoq të nxirrte në pah anën njerëzore të gruas dhe të rizgjonte forcën e saj, të cilën koha e injorancës e ka groposur, duke e mpakur si qenie mendërisht, moralisht dhe praktikisht. Ky është një libërth

që synon rikthimin e femrës në funksionin e rëndësishëm në shoqëri dhe në rolin e saj të natyrshëm, që ia ka caktuar Zoti që në krijim.

Ç' mendim ka Imam Khomeini për gruan?

Çfarë roli ka ajo në shoqëri?

Le të lexojmë së bashku këto faqe të këtij libri që përmbajnë mendimin e tij rreth gruas.

PJESA E PARË

Pozita e gruas

Mëkëmbësi i Allahut

Përpara se të jetë femër, gruaja është një njeri, është mëkëmbëse e Allahut në faqen e tokës: **“dhe ti përkujto kur Zoti yt u tha melaikeve se Unë do të krijoj një mëkëmbës në tokë...”**² i cili do të bartë peshën e përgjegjësisë hyjnore; **“Ne ua ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete...”**³.

Atë e lartëson nderimi hyjnor: **“Ne vërtet i nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam atyre të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me**

² Sure “Bekare”, ajeti 30.

³ Sure “Ahzab”, ajeti 72.

ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.”⁴

Asnjë individ nuk bën dallim prej së keqes, qoftë mashkull apo femër, vetëm se me anë të devotshmërisë: “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë juve popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat).”⁵

Këtë na e citon edhe Imam Khomeini, i cili thotë: “Ligji i ka bërë një vlerësim të madh të drejtave të grave dhe pjesës tjetër të grupeve dhe shtresave. Në Islam nuk ekzistojnë ndasi dhe dallime ndërmjet një grupi dhe një tjetri, por veçantia qëndron vetëm te devotshmëria.”⁶

Pra, gruaja është mëkëmbësja, është e nderuara, është ajo që e bart mbi supe amanetin hyjnor dhe që është e ngarkuar për t’i dhënë jetë kësaj bote, njësoj sikurse burri. Imam Khomeini thotë: “Gruaja është qenie madhështore ...”⁷

⁴ Sure “Isra”, ajeti 70.

⁵ Sure “Huxhurat”, ajeti 13.

⁶ Shkëputje nga një fjalim i mbajtur më 1.4.1979.

⁷ Nga një fjalim i Imam Khomeinit për nder të Ditës së Gruas, 6.5.1979.

Imam Khomeini bën thirrje për ta kthyer vëmendjen drejt pozitës njerëzore të gruas: “Ne bëjmë thirrje që gruaja të fitojë pozitën e saj të lartë njerëzore.”⁸

Islami dëshiron që ajo të përparojë: “Islami i nxit burrin dhe gruan që të lartësohen në shkallët e përsosjes.”⁹

Ky është vizioni i përgjithshëm i Islamit për gruan, për këtë krijesë të bekuar, të cilën Allahu i Lartësuar e krijoi me duart e Tij. Ajo është një njeri dhe ka përgjegjësi që të veprojë në bazë të kësaj, të ecë drejt përmbylljes së qëllimeve të larta njerëzore e drejt hapave të përsosjes.

⁸ Shkëputje nga një fjalim në tubimin e grave në Kum, 6.3.1979.

⁹ Shkëputje nga një fjalim i mbajtur më 9.11.1978.

Dita e Gruas

Imam Khomeini i ka dhënë një rëndësi të madhe çështjes së gruas, aq sa i caktoi asaj një ditë të veçantë që përsëritet çdo vit, me qëllim që problemet, të drejtat dhe emocionet e saj të mbeten përherë të pranishme. Për këtë, ai thotë: “Qoftë ditë e begatë për popullin e madh iranian, e në veçanti për gratë e respektuara, festa e bekuar e gruas. Kjo ditë është ditë e lavdishme. Është dita e lindjes së xhevahirit vezullues, e cila në esencë ka ekzistuar për mirësitë njerëzore dhe për vlerat e larta të mëkëmbësisë së Allahut në faqen e tokës, hazreti Fatime Zahraja (*Paqja qoftë mbi të!*).”¹⁰

Për të, ai zgjodhi një nga ditët më fisnike të njerëzimit dhe një ndër më të nderuarat në zemrën e tij: ditën e lindjes së fisnikes Fatime Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*). Ditën e kësaj gruaje të përsosur, për të cilën është thënë se është thelbi i mirësive njerëzore dhe i vlerave të larta. Ai e zgjodhi këtë ditë për gruan, jo në mënyrë rastësore por sepse ajo bart në vetvete dy çështje me rëndësi.

Ai e kthen vëmendjen drejt rëndësisë së gruas dhe rolit të saj thelbësor në shoqëri, një rol ky i mishëruar në

¹⁰ *El Kelimatul kisar*, f. 285.

më të nderuarën Fatime (*Paqja qoftë mbi të!*), në pozitën dhe shkallët më të larta.

Nga ana tjetër, dita e zgjedhur nga Imam Khomeini për gruan është dita e shembullit më të mirë e më të përsosur për të. Dita në të cilën gruaja do të fillojë jetën e saj çdo vit. Kjo është dita e të nderuarës Fatime (*Paqja qoftë mbi të!*), është dita e shembullit dhe e modelit që duhet t'u prezantohet grave. Prej këtyre të fundit kërkohet që të ndjekin rrugën e saj.

E gjitha kjo na tregon rëndësinë e gruas dhe pozitën e saj të lartë në optikën e Imam Khomeinit.

Çfarë i ka dhënë Islami gruas?

Islami i ka shërbyer gruas në një mënyrë të pashembullt në histori, duke e nxjerrë atë nga baltosjet e poshtërimit dhe duke e nderuar e vlerësuar si një qenie njerëzore me personalitet.”¹¹

Islami nuk i ka shërbyer burrit njësoj siç i ka shërbyer gruas. Vërtet, gratë nuk e dinë se si ka qenë trajtuar gruaja në kohën e injorancës dhe se si ka kontribuar Islami për të.”¹²

Nuk ka qenë e lehtë që me standartet e materializmit, ai njeri i madh (Pejgamberi /*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të qëndronte në mesin e njerëzve të kohës së injorancës dhe të thoshte: **“dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla, për çfarë mëkati janë mbytur...”**¹³

Në shumë pak vite, ky Pejgamber i nderuar arriti që me anë të një mrekuillie hyjnore, ta përmbyste atë shoqëri hermetike, e cila e kishte dhunuar të drejtën e femrës dhe e kishte përbuzur atë, derisa arriti në varrosjen fizike pas

¹¹ Shkëputje nga fjalimi i datës 9.11.1978.

¹² Shkëputje nga fjalimi i datës 9.11.1798.

¹³ Sure “Tekuir”, ajetet 8-9.

varrosjes së saj shpirtërore, duke e shndërruar atë në një element shkatërrimi dhe prishjeje të shoqërisë.

Islami arriti që ta përmbyste dhe ta shndërronte atë shoqëri, në të cilën: **“Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij priset dhe bëhet plot mllef. Ai fshihet prej njerëzve, për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua (e konsideron telash dhe jo dhuratë prej Zotit). Mandej, (mendon) a do ta mbajë atë, ashtu i përrulur, apo do ta mbulojë atë (të gjallë) në dhe’.** Sa i keq është ai gjykim i tyre!”¹⁴

Islami ngriti një shoqëri, në të cilën shpallet se: “Xheneti është nën këmbët e nënës”. Kjo është vetëm një pjesë e asaj që i ka dhënë Islami gruas, thjesht me ardhjen e tij. Ky shërbim nuk kufizohet vetëm te gruaja në veçanti, por është një shërbim për të gjithë shoqërinë në përgjithësi. Imam Khomeini thotë: “Islami e ka mirësuar shumë femrën duke e nxjerrë nga ajo errësi që e mbulonte në kohën e injorancës (xhahilijetit). Në atë kohë, gruaja ishte e poshtëruar. Ajo kosiderohej më e ulët sesa kafsha. Ndërsa Islami e nxori atë nga kënetat e injorancës.”¹⁵

¹⁴ Sure “Nahl”, ajetet 58-59.

¹⁵ Shkëputje nga fjalimi në Ditën e Gruas, 6.5.1979.

Edhe pse Islami i ka munguar shoqërisë përgjatë historisë, pozita e femrës ka rënkuar edhe pas daljes së tij rishtazi.

“Tashmë është rikthyer Dita e Gruas, e kësaj qenieje jetësore në shoqëri, pozita e së cilës lidhet me begatinë e ringritjes së Islamit.”¹⁶

¹⁶ Shkëputje nga fjalimi në Ditën e Gruas, 5.5.1980.

Vajza është shumë e mirë!

Ryhejmjani në librin e tij thotë: “Allahu i Lartësuar më bekoi me një fëmijë tjetër dhe ishte vajzë. Disa ditë pas lindjes së saj doja ta çoja tek Imam Khomeini. Pa i mbaruar akoma parmakët e shkallëve, vura re shikimin e Imamit, i cili me nxitim më lejoi që të hyja, duke më pritur me buzëqeshje në fytyrën e tij fisnike. Përpara se të thoja diçka, ai më pyeti: “Është fëmija yt?” “Po” – iu përgjigja. Ai i zgjati menjëherë duart për të marrë fëmijën prej meje, duke vazhduar: “Është djalë apo vajzë?” I thashë: “Është vajzë.” Imami e mori dhe e shtrëngoi në krahëror, e vendosi fytyrën e tij në fytyrën e saj dhe e uthi, duke thënë: “Vajza është shumë e mirë... vajza është shumë e mirë, vajza është shumë e mirë!” Pasi i bëri një lutje në veshin e saj, më pyeti: “Si ia ke vënë emrin?” I thashë: “Akoma nuk ia kam vënë. E lashë që t’ia vinit ju”. Menjëherë tha: “Fatimeja është shumë e mirë, Fatimeja është shumë e mirë, Fatimeja është shumë e mirë.”¹⁷

¹⁷ “Durr Sajih Eftab”, f. 126.

PJESA E DYTË

Midis të drejtave dhe përsosurisë

Gruaja është një qenie njerëzore, dhe jo një mall për t'u shitur

“Islami e ka refuzuar me forcë shndërrimin e gruas në një mall pazari”.¹⁸

“Gruaja duhet të jetë e lirë ashtu sikurse të gjithë njerëzit e tjerë”.¹⁹

Trupi i gruas bart një shpirt që posedon përsosmërinë, dëshirat, ambiciet, shpresat dhe dhimbjet e saj. Ajo është një qenie e aftë për t'u realizuar në hapësirën e lirisë, derisa të lidhet me mbretërinë e Allahut. Ajo është një robëreshë e Allahut dhe e askujt tjetër përveç Tij. Kjo

¹⁸ Nga takimi me gazetën franceze “Le Monde”, 6.5.1978.

¹⁹ Nga një fjalim në lidhje me prerjen e marrëdhënieve me shtetet që mbështesin Shahun, 11.12.1987.

është pikëpamja e Islamit për gruan. Kushdo që e kundërshton këtë pikëpamje dhe që bëhet pengesë e caktimit të gruas si një njeri që ka një shpirt, që ka shpresa dhe një progres shpirtëror, është i refuzuar nga Islami.

Gruaja nuk mund të kufizohet vetëm nga ana trupore dhe nga pamja e saj e jashtme. Kjo nuk u vjen përshtat tregtarëve të mishit të bardhë, xhelatëve të shpirtit dhe armiqve të pastërtisë, të cilët nuk shohin gjë tjetër tek femra, përveçse kënaqësisë, apo pasurisë për tregti. Kështu, ata e zhytën femrën në kënetën e tyre dhe e mashtruan atë deri në atë masë sa ta shohë baltën e kënetës si ujë të kthjellët!!!

1- Liria e gruas

Para së gjithash, është normale që të pyesim: Çfarë është liria? Nuk ka dyshim se përcaktimi i qartë i nocionit do t'i presë rrugën parrullave rrezatuese nga ana e jashtme e saj dhe që janë boshe, apo kundërshtuese të përmbajtjes së saj! Që të bëhet si këmisha e Osmanit, që e ngre lart gjithkush që ka një qëllim politik apo ambicie për pasuri ose për famë!

Çfarë është liria?

Liria është dhënia e zgjedhjeve në duart e njeriut, njohja e tij me to dhe zbulimi i të vërtetave të atyre zgjedhjeve në mënyrë që pas kësaj të zgjedhë atë që e sheh të dobishme për veten e tij. Kjo është liria e vërtetë, çlirimi i lirisë së zgjedhjeve.

Nuk është kjo, ajo moskokëçarje për të cilën Imami (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Me të vërtetë, ju flisni për atë liri që e bën rininë tonë moskokëçarëse. Secili vepron atë që dëshiron. Fuqitë e mëdha merren me grabitjen e pasurive tona, kurse kjo rini është e zhytur në zbavitje dhe lojë.”²⁰

Kjo është ajo moskokëçarja, ku mund të bien shumë prej të rinjve, duke imagjinuar sikur janë të lirë. Ata janë sikurse struci, i cili e fut kokën e tij në dhe’ e mendon se armiku i tij nuk do ta shikojë. Në të vërtetë, kjo është një rrugë qorre dhe s’ka asnjë lidhje me lirinë.

Liria nuk është kështu. Nuk është liri ajo që i vë prangat shoqërisë dhe që e detyron atë të jetë thjesht një ndjekëse dhe pasuese e dikujt tjetër. “Po t’i shihnit gratë në ato situata që kanë dëshiruar për veten e tyre nën

²⁰ Shkëputur nga një fjalim drejtuar bijve të popullit, më 24.8.1979.

pretendimin e “çlirimit”, do ta kuptonit se e gjithë kjo nuk ka qenë gjë tjetër, veçse një mashtrim dhe iluzion. As burrat dhe as gratë nuk kanë qenë të lirë, madje as gazetat dhe radioja. Qëllimi i tyre nuk ka qenë liria. Është e vërtetë se me emër, në biseda e në propagandë liria përsëritej shpesh, por lirinë që e udhëheq rininë tonë drejt një rruge qorre e pa kthim, unë e emërtoj si liri të importuar, liri kolonizuese. Pra, ajo është liria që përhap qytetërimin që ata dëshirojnë, në mënyrë që rinia jonë të jetë ndjekëse e saj. Këto lloj lirish, ata i sjellin si dhurata.”²¹

Po, një pjesë e rinisë, një pjesë e djemve dhe e vajzave, mund të imagjinojnë se të qëniti i lirë është braktisja e vetvetes dhe ndjekja e traditës së dikujt tjetër, duke mos qenë të vetëdijshëm se ndjekja e tjetrit është robëri dhe të bën të varur.

Po ashtu, liri nuk do të thotë që të izolosh fuqitë e gruas dhe t’i shtysh ato drejt një boshti të vetëm: “Ne nuk e lejojmë, por as Islami nuk e pranon që femra të jetë një mall dhe një marionetë në duart tona. Islami bën thirrje për ruajtjen dhe mbrojtjen e personalitetit të gruas dhe dëshiron që prej saj të ndërtojë një njeri serioz dhe të dobishëm. Ai nuk e lejon në mënyrë kategorike

²¹ Nga fjalimi në një tubim me familjarët e dëshmorëve, më datë 17.9.1979.

shndërrimin e gruas në vegël apo në instrument të pasionit në duart e burrave.”²²

Islami dëshiron çlirimin e gruas nga prangat që ia ka vënë shoqëria që prej lindjes së saj.

Imam Khomeini thotë: “Islami nuk e ka kundërshtuar kurrë lirinë e gruas. Përkundrazi, ai ka luftuar kundër shndërrimit të saj në një mall pazari, duke ia rikthyer asaj krenarinë, nderin dhe pozitën e vet. Ajo është e lirë të zgjedhë rrugën dhe aktivitetin e saj. Qeveria e Shahut përpiqej ta mbyste femrën në çështje që bien ndesh me moralin, kurse Islami e kundërshton me forcë këtë gjë. Sistemi genocid e konfiskoi dhe e mbërtheu lirinë e gruas, njësoj sikurse e mbërtheu dhe e ndaloi edhe lirinë e burrit, kurse ne përpiqemi që t’i japim gruas lirinë përkundrejt shturjes ku ata e kanë hedhur.”²³

Shturja dhe prishja janë zinxhirët që e burgosin gruan, kështu që pikëpamja për gruan në shoqërinë e prishur është një pikëpamje e ngushtë nga një këndvështrim i veçantë. Gjithashtu, ajo që pret kjo shoqëri prej saj lidhet me çështje të ngushta. Kur do ta kuptojë femra lindore dhe ajo perëndimore, se ky është një burg për të, i veshur me rrobën e lirisë?!

²² Nga një takim me doktor Xhim Kukler Raft , më datë 28.12.1978.

²³ Nga një takim me gazetën franceze “Le Monde” më datë 6.5.1978.

Ndalimi i mbulesës islame është një model i çlirimit të tyre

A nuk ju mjafton si argument dhe fakt për atë çfarë përmendëm, ajo çfarë ndodh në disa vende perëndimore, madje edhe në disa vende të lindjes, duke i dëbuar vajzat e veshura me hixhab nga shkollat, universitetet dhe kompanitë, thjesht dhe vetëm sepse janë femra të mbuluara?!

Imam Khomeini thotë: “Nuk ka asnjë dyshim se femrat nuk janë detyruar për këtë zgjedhje! Përkundrazi, janë vetë ato që e kanë bërë këtë zgjedhje. Pra, me ç’të drejtë ua merrni zgjedhjen nga duart e tyre?”²⁴

Vërtet, filmat tendenciozë dhe helmues si dhe thëniet e oratorëve injorantë, në pesëdhjetë vitet e zeza të sundimit Bahlevijan, e shndërruan femrën në një mall të thjeshtë tregtie. Ata kanë punuar për të tërhequr femrat, të cilat kanë qenë të gatshme që të ndikoheshin nga këto prirje, drejt vendeve që askush nuk i përmend ato. Le të rikthehet ai që dëshiron të lexojë, e të kuptojë frymën e atyre krimeve nëpër gazeta, revista, poezitë fundërrina dhe të pista në kohën e Rida Khanit, duke filluar që me periudhën kohore të detyrimit të femrave për t’u zbuluar

²⁴ Në një takim me Oriana Falaxhi, më datë 12.9.1979.

dhe zhveshur nga hixhabi islam. Allahu ua nxiu fytyrat e tyre dhe ua shkatërroi lapsat, me të cilët pretendonin iluminimin.”²⁵

Po përse refuzohej hixhabi prej tyre?

Arsyeja është sepse femra e mbuluar jep modelin e njeriut që e di se ajo ka të drejtë që mashkulli dhe e gjitha shoqëria ta shohin dhe ta vlerësojnë atë si një qenie me personalitet dhe me vlera.

A ka robëri më të padrejtë e më të ashpër sesa kjo? A nuk është e çuditshme që ai, i cili hap para femrës të gjitha dyert e anës njerëzore, të akuzohet se e robëron atë?

Islami nuk ka varrosur dhe nuk do varrosë kurrë asnjë gjë brenda femrës, por ka rregulluar për të çdo gjë.

²⁵ Nga një fjalim për nder të Ditës së Gruas, datë 5.5.1980.

Liria përfundon aty ku preken të drejtat e të tjerëve

Liria ime përfundon aty ku fillojnë të drejtat e të tjerëve, kështu që unë jam i lirë për atë që më përket mua. Mirëpo, unë nuk jam i lirë të grabis pasuritë e njerëzve. Jam i lirë në punën time, por nuk jam i lirë për të bërë vetëvrasjen e ndaluar. Kështu pra, e gjithë liria përfundon në kufijtë e të drejtave të njerëzve. E tillë është edhe e ashtuquajtura liri e gruas. Imam Khomeini thotë: “Ashtu sikurse Allahu i Lartësuar u ka vënë fre burrave, që epihet dhe pasionet e tyre të mos i çojnë ata drejt prishjes dhe shkatërrimit, po kështu ka vepruar edhe me femrat. E gjitha kjo është bërë vetëm për të mirën dhe përmirësimin e tyre. Të gjitha ligjet islame janë në shërbim të rregullimit të shoqërisë.”²⁶

Liria prej së cilës lind prishja dhe shkatërrimi i shoqërisë nuk është liri veprimi, por është një padrejtësi ndaj shoqërisë dhe dhunim i të drejtave të saj.

“Gratë janë të lira në zgjedhjen e punës dhe rrugës së tyre, duke ruajtur ekuilibrat. Eksperienca gjatë

²⁶ Shkëputje nga një fjalim në një tubim të grave në Kum, më datë 1.2.1380.

aktiviteteve na ka provuar me fakte se femrat e kanë gjetur lirinë e tyre në veshjen islame."²⁷

Kjo është ajo liria dhe natyrshmëria, për të cilën bën thirrje Islami.

2 - Të drejtat e gruas

Në sistemin islam, gruaja gëzon të drejtat që gëzon edhe burri, siç janë: e drejta e studimit, e punës, e pronësisë, e zgjedhjes dhe e kandidimit. Edhe në fusha të tjera, ku burri luan rolin e tij, edhe gruaja ka të drejtë të luajë rolin e saj.

Duhet pasur parasysh se ka disa punë, zbatimi i të cilave konsiderohet i ndaluar nga ana e burrave, sepse ato të çojnë drejt prishjes dhe shkatërrimit, kurse për disa të tjera rekomandohet që të merren përsipër nga femra.

Islami dëshiron për femrën dhe mashkullin që ta ruajnë qenien e tyre, e kurrsesi që femra të bëhet një lodër në duart e mashkullit. Ajo që veprojnë të tjerët jashtë Islamit me femrën, s'ka asnjë bazë dhe është vetëm një propagandë boshe që përhapet nga qëllimkëqinjte dhe të

²⁷ Fjalë nga një takim me Elizabet Tarkud, më datë 1.11.1978.

padrejtët. Në të kundërt me këtë, si femra ashtu edhe mashkulli, u gëzohen mirësive në Islam.²⁸

Njeriu ka të drejtë të veprojë atë që do, në mënyrë që të ngrejë lart pozitën e vet dhe t'i shërbejë shoqërisë. Ai nuk ka asnjë të drejtë që ta dëmtojë veten apo shoqërinë e vet, qoftë ky njeri burrë apo grua, prandaj edhe Islami i ka vënë kufinj si gruas, ashtu edhe burrit, të cilët i pengojnë ata për ta dobësuar apo dëmtuar shoqërinë.

Imam Khomeini thotë: "Islami i vlerëson së tepërmi të drejtat e grave, njësoj sikurse edhe të drejtat e burrave, mirëpo për gratë është kujdesur dhe u ka dhënë rëndësi pak më shumë sesa burrave. Ato janë të lira të kryejnë aktivitetet e tyre me dëshirën dhe vullnetin e tyre të plotë, ashtu siç janë të lira që ta përzgjedhin vetë punën. Nuk duhet lënë pa përmendur se në Lindje ka edhe kufizime për burrat, dhe kjo në dobi të vetë atyre. Kështu, Islami e ka ndaluar praktikimin e punëve që në to ka shkatërrim për burrat, siç janë: kumari, përdorimi i pijeve alkoolike apo drogërat e ndryshme. Të gjithë këta janë kufinj në dobi të vetë shoqërisë."¹²

²⁸ Nga një takim i Imami me datë 7.12.1978.

Gruaja dhe puna

Islami nuk e ndalon gruan që të punojë, duke respektuar dhe duke u kujdesur për dispozitat e Sheriatit. Imam Khomeini thotë: “Gruaja le të punojë, por e mbuluar me hixhab. Nuk ka asnjë problem që ajo të punojë në dikasteret e shtetit, por duke ruajtur hixhabin e sheriatit dhe duke u kujdesur për të.”²⁹

Braktisja e mbulesës sheriatike dhe e modestisë, do ta shndërrojë rolin e saj në kompanitë apo qendrat e punës, nga një rol konstruktiv dhe efektiv në shërbim të shoqërisë, në një rol devijues dhe shkatërrues, duke bërë që respekti për qenien e saj të humbasë plotësisht.

Pra, gruaja ka të drejtë që të luajë një rol efikas në shoqëri, me përgjegjësinë e ruajtjes së sheriatit.

Mirëpo, nëse si burri, ashtu edhe gruaja janë individë që duhet të ruajnë të drejtat e tyre, atëherë cili është shkaku i konfliktit midis tyre në disa ligje të sheriatit? Ky konflikt, a nënkupton dallim apo mungesë barazie?

Le të hedhim një vështrim rreth temës së barazisë.

²⁹ Bisedë me një grup dijetaësh të fesë dhe student të shkencave fetare në qytetin e Kunit, më datë 6.3.1979.

Barazia

Përdorimi i çështjeve të ndryshme dhe i temave të dyshimta vetëm në një metodë apo mënyrë, nuk është as drejtësi, as paanshmëri dhe as barazi. Përkundrazi, kjo formë është pa dyshim një padrejtësi, një zullum. Nëse dëshiron që të sprovosh dy persona, njëri prej të cilëve është mjek dhe tjetri ndërtues, është e arsyeshme që pyetja e parë të jetë për mjekësinë, kurse e dyta për ndërtimin. Kjo është ajo drejtësia dhe paanshmëria. Kurrsesi nuk është drejtësi, që të dy personave t'u bëhet një pyetje rreth mjekësisë, sepse në këtë rast do t'i bëhej padrejtësi ndërtuesit. Po kështu, nuk është e drejtë që t'u bëhet që të dyve një pyetje rreth ndërtimit, sepse do i bëhej padrejtësi mjekut.

E njëjta logjikë vlen edhe për çështjen e burrit dhe të gruas. Vërtet që secili prej tyre është njeri, por ata kanë tipare dhe veçori të ndryshme që duhet të merren parasysh kur shpërndahen përgjegjësitë dhe detyrat ndërmjet tyre.

Imam Khomeini thotë: "Islami e sheh gruan si të barabartë me burrin. Sigurisht që ekzistojnë ligje të veçanta që harmonizohen me natyrën e burrit, si dhe disa të tjera

që i përshtaten natyrës së gruas, por kjo nuk do të thotë se Islami bën dallim midis gruas dhe burrit.”³⁰

Dallimi midis burrit dhe gruas është i qartë në të dyja aspektet, si në atë fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror. Në aspektin fizik, gruaja ka kushte specifike, të tilla si: shtatzania, lindja dhe gjdhënia, kurse në aspektin shpirtëror, ajo anon nga dhembshuria, butësia dhe mirësia. Nga ana tjetër, burri anon më tepër drejt vrazhdësisë dhe ashpërsisë. Këto cilësi fizike dhe shpirtërore duhen patur kujdes gjatë shpërndarjes së detyrave të rëndësishme midis burrit dhe gruas, në mënyrë që t’u jepet ajo që përshtatet me cilësitë përkatëse trupore dhe shpirtërore.

Ligjvënësi, i cili vendos vetëm një ligj, si për burrin, ashtu edhe për gruan, pa vërejtur mirë karakteristikat e atyre të dyve, është një ligjvënës zullumqar, sepse ligji është i padrejtë për të dyja gjinitë. Marrja në konsideratë e këtyre dallimeve dhe vendosja e ligjeve të ndryshme duke u bazuar mbi to, është drejtësia dhe barazia e vërtetë.

³⁰ Nga një fjalim drejtuar popullit iranian, më datë 11.12.1987.

Arsimi

Imam Aliu (*Paqja qoftë bi të!*) ka thënë: “Dituria është rrënja e çdo vepre të mirë, kurse injoranca është rrënja e çdo vepre të keqe”.

Kur’ani nuk ka përmendur në asnjë ajet të tij se dija është specifike për burrat, si dhe as nuk e ndalon që gruaja të marrë dituri, apo të studiojë. Përkundrazi, Kur’ani ka urdhëruar për mësimin e dijes dhe e ka përmendur procesin e të mësuarit më shumë se 770 herë!

Kur’ani e konsideron diturinë një të drejtë, madje si një obligim për të gjithë shoqërinë, dhe nuk e ka përmendur as edhe në një ajet të vetëm specifikimin e dijes për burrat.

Këtë të vërtetë e qartësojnë edhe hadithet profetike, në njërin prej të cilëve Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kërkimi i diturisë është farz për çdo mysliman dhe myslimane”.

Imam Khomeini ka folur për rëndësinë e marrjes së dijes nga ana e gruas në shumicën e thënieve të tij. Në njërën prej tyre, ai thotë: “Një nga efektet e mëdha të kësaj rilindjeje dhe progresi, është kjo forcë e madhe që ju të

gjithë keni arritur, është forca e grave, e vëllezërve dhe e motrave, si dhe kjo ndjenjë përgjegjësie ndaj vendit, prej së cilës është edhe përgjegjësia e mësimdhënies, të mësuarit e asaj që është e dobishme për fenë dhe për këtë botë.”³¹

Imam Khomeini, diturinë e gruas nuk e ka konsideruar si një të drejtë të saj, por si një përgjegjësi të saj. Si rrjedhim, ajo futet tek obligimet dhe jo vetëm tek të drejtat. Madje, ai e konsideron adhurim marrjen e dijes nga burrat dhe gratë: “O vëllezër e motra të besimit! Përqendrohuni në mobilizimin e forcave tuaja për të shmangur këtë mangësi të dhimbshme dhe shkulini rrënjët e këtij problemi! Allahu i Lartësuar na ka bërë thirrje për mësimdhënien dhe nxënien e dijes.”³²

Nuk mjafton të marrësh përsipër këtë përgjegjësi, sikurse e kryen shteti rolin e vet nëpërmjet shkollimit e arsimit. Imam Khomeini bën thirrje për ta kthyer dijen dhe nxënien e saj në një mision publik, që bie si një barrë mbi çdokënd që është i aftë për ta praktikuar. Ai thotë: “Detyra e Imamëve të xhamive dhe drejtuesve të xhematit nëpër qytete dhe fshatra, është që t’u bëjnë thirrje njerëzve për t’u mësuar motrave dhe vëllezërve shkrim e lexim. Ata nuk duhet të rrinë e të presin ndërmarrjen e hapave nga

³¹ Nga një takim me organet e një asambleje për arsimin, datë 16.9.1979.

³² Nga një fjalim mbi luftën kundër analfabetizmit, më datë 28.12.1979.

ana e qeverisë. Kurse obligimi i atyre që janë analfabetë, është që t'i përgjigjen kësaj iniciative.”³³

Imam Khomeini i nxit gratë për t'u arsimuar dhe i lavdëron për këtë: “Sot nuk gjeni asnjë qytet apo fshat, ku të mos bëhen tubime kulturore dhe shkencore të grave të angazhuara si dhe amvisave të nderuara e të respektuara myslimane.”³⁴

Prej arsimimit nuk ka përjashtuar madje as gruan e moshuar: “Nëse kanë mundësi, si burri i moshuar, ashtu edhe gruaja e moshuar, le të mësojnë, në mënyrë që të mos dëshpërohen.”³⁵

E lus Allahun e Madhëruar që të na japë sukses, o ju burra e gra të nderuara, që të mund të kurorëzoni përpjekjet tuaja në përfitimin e dijes, në punë dhe në rrënjosjen e moralit, sepse vetëm dija në vetvete nuk mjafton, por të gjithë këta elementë të ndërthurur së bashku e lartësojnë pozitën e njeriut.”³⁶

³³ Nga një fjalim mbi luftën kundër analfabetizmit, më datë 28.12.1979.

³⁴ Nga një fjalim me rastin e Ditës së Gruas, më datë 5.5.1980.

³⁵ Nga një bisedë gjatë një tubimi me përgjegjësit e lëvizjes kundër analfabetizmit, më datë 27.12.1980.

³⁶ Nga një bisedë në tubimin e grave në Kum, më datë 8.4.1984.

Gruaja në rrethet shkencore

Arsimimi i grave kryhet në shumë institute të veçanta, ku atyre u jepet një rëndësi e madhe. Imam Khomeini e ka konsideruar këtë një mirësi prej Allahut të Lartësuar. Duke folur në lidhje me këtë, ai thotë: “E falënderoj Allahun e Madhëruar që sot gjeta një institucion në fazën e përgatitjes në qytetin e Kunit, i cili do të marrë përsipër përgjegjësinë e arsimimit dhe të edukimit të grave. Shpresojmë që të realizohet ky qëllim islam me përpjekjet e dijetarëve të shquar dhe të mësuesve të rretheve shkencore në Kum. Lusim Allahun që kjo sipërmarrje të jetë një hap efektiv në zhvillimin intelektual dhe lulëzimin e dijes islame tek gratë.”³⁷

Në qytetin e Kunit gjendet një numër i madh institucionesh të dijes islame për gratë.

³⁷ Nga një ligj që e ka publikuar në lidhje me sigurinë publike të Zyrës së Motrave në Kum.

PJESA E TRETË

Roli i gruas në ndërtimin e shoqërisë

Gruaja është një pjesë e rëndësishme e shoqërisë

Allahu i Madhëruar thotë: **“Besimtarët dhe besimtare janë miq të njëri-tjetrit, që urdhërojnë për vepra të mira dhe ndalojnë nga të këqijat.”**

Nuk ka asnjë dyshim se Islami nuk dëshiron që t'i hedhë tutje energjitë e gruas dhe ta mohojë çfarëdolloj roli të saj në shoqëri, përkundrazi ai i orienton ato energji në drejtimin e duhur, në mënyrë që ajo të ketë rolin e vet pozitiv dhe konstruktiv në shoqëri.

Pra, gruaja nuk është një pjestar jashtë shoqërisë apo në një cep të saj, por ajo është në zemër të shoqërisë dhe ka rolin e saj thelbësor dhe ndikues. Imam Khomeini e tregon në mënyrë të përmbledhur këtë rol në shumë nga fjalimet e tij. Në një prej tyre, ai thotë: “Nuk ka dyshim se gruaja ka

një rol të rëndësishëm në shoqëri. Ajo është forma për të përmbushur shpresat e njerëzimit.”¹

Islami e nxit gruan, që njësoj sikurse edhe burri, të ketë rolin e saj në të gjitha çështjet.”²

Imami thotë se gratë e mira (salihat) janë shkak i ngritjes lart të shoqërisë dhe triumfit të saj ndaj sfidave: “Nëse popujt privohen nga gratë guximtare dhe edukuese, atëherë ata do të shkatërrohen dhe do të shkojnë drejt degradimit.”³

Gratë i zhvillojnë dhe i bëjnë të banueshme vendet, krah për krah burrave.

“Ashtu sikurse ju gratë keni pasur një rol thelbësor në të shkuarën, edhe sot ju kërkohet kontributi për arritjen e triumfit. Ju duhet të merrni pjesë në bisedime sa herë që të jetë e nevojshme. Është detyra juaj që të merrni pjesë në ndërtimin e vendit.”⁴

Imam Khomeini e përmend më tej natyrën e rolit të gruas dhe thotë: “Ne krenohemi që gratë luajnë rolin e tyre aktiv në fushat kulturore, ekonomike dhe ushtarake njësoj si burrat, apo edhe më mirë, duke u përpjekur për ngritjen sa më lart të Islamit dhe për realizimin e qëllimeve të Kur’anit Famëlartë.”⁵

Imam Khomeini ka folur për kontributet e rëndësishme të gruas, disa prej të cilave do t'i përmendim më poshtë:

1- Kontributi në përcaktimin e fateve të vendit

“Është obligim për gruan që të japë kontributin e saj në projektimin e të ardhmes së vendit.”³⁸

“Nëse duam që gruaja të arrijë pozitën e saj të lartë, atëherë ajo duhet të kontribuojë në përcaktimin e fatit të saj.”³⁹

“Gruaja ka të drejtën për të marrë në dorë fatin e saj, ashtu sikurse edhe burri.”⁴⁰

Pra, gruaja ka një rol të rëndësishëm në vendime dhe është detyra e saj që të japë mendim për çështje të caktuara, e në mënyrë të veçantë për ato që kanë lidhje me të.

³⁸ Nga një bisedë në tubimin e grave të Kunit, më datë 6.3.1979.

³⁹ Nga një bisedë në tubimin e grave të Kunit, më datë 6.3.1979.

⁴⁰ “El Kelimatul Kisaru”, f. 283.

2- Kontributi i gruas në familje

“Kur’ani Famëllartë e edukon njeriun, por një rol të rëndësishëm edukativ ka edhe gruaja.”⁴¹

Gruaja është shkolla prej së cilës del njeriu. Në lidhje me këtë, poeti thotë:

Allahu nuk e ndëshkon nënën time, sepse vërtet ajo ka pirë dashurinë e trashëgimitarit dhe më ka dhënë mua qumësht.

Duke folur për rolin e burrit dhe të gruas, Imam Khomeini thotë: “Roli i gruas në shoqëri është më i rëndësishëm sesa roli i burrit, sepse gratë përveç se janë vetë një pjesë e rëndësishme e shoqërisë, ato edukojnë edhe pjesën tjetër.”⁴²

Meqenëse roli i gruas është i rëndësishëm, atëherë edhe shpërblimi për të është i madh. Duke folur për këtë, Imam Khomeini thotë: “Një natë e vetme e nënës, e kaluar pa gjumë, është e barazvlefshme me gjashtëdhjetë vite angazhimi në punë nga ana e babait. Vërtet, dhembshuria dhe mëshira që bartin shikimet e nënës, nuk janë gjë tjetër

⁴¹ Nga një bisedë në tubimin e grave të Kunit, më datë 6.3.1979.

⁴² “El Kelimatul Kisaru”, f. 279.

vetëm se respekt dhe lartësim i dhembshurisë dhe mëshirës së Zotit të botëve.”⁴³

Nëna mjafton të nderohet e të respektohet duke iu referuar hadithit fisnik: “Xheneti është poshtë këmbëve të nënës.”⁴⁴

Rëndësia e edukimit

Edukimi formon kapacitetin kulturor, personal dhe moral të njeriut përgjatë jetës së tij.

Në një transmetim nga Prijësi i besimtarëve thuhet: “Vërtet, zemra e fëmijës është njësoj si toka e pambjellë. Çdo gjë që hidhet në të, ajo e përthith.”

Duke folur mbi këtë temë, Imam Khomeini thotë: “Pa dyshim se shumica e kurtheve dhe intrigave janë produkt i komplekseve që krijohen tek fëmijët.”⁴⁵

Më tej, ai shprehet: “Një fëmijë i mirë, që edukohet nga përkujdesjet tuaja (o nëna), ka shumë mundësi që të gëzojë një popull të tërë.”⁴⁶

⁴³ “Xhaluhaj Rahmani”, f. 47.

⁴⁴ “Kenzul Ummal”, hadithi 45439.

⁴⁵ Nga një bisedë në tubimin e grave në qytetin e Ahvazit, më datë 2.7.1979.

Pra, kjo është rëndësia e rolit të gruas. Ajo i nxjerr në dritë individët e kësaj shoqërie punëmirë, ku njëri prej tyre mundet që të kënaqë e të gëzojë një popull të tërë.

Në të kundërt, edukimi i keq çon në prishjen e brezave. Në lidhje me këtë, Imam Khomeini thotë: “Nëse edukimi është i keq, atëherë ai do ta prishë shoqërinë. Mos mendoni se bëhet fjalë për një fëmijë të vogël, pasi ky fëmijë do t’i bashkohet shoqërisë dhe do të marrë një pozicion në krye të saj, e më pas e çon atë drejt shkatërrimit.”⁴⁷

Roli i rëndësishëm i edukimit është një nderim i madh për gruan. “Vërtet, ju o gra, lumturoheni me mëmësinë. Ajo është një nderim, me të cilin ju keni përparësi ndaj burrave. Pa dyshim se shkolla e parë ku njeriu mëson, është nëna. Nëna e mirë edukon një fëmijë të mirë. Nëse nëna është e devijuar nga rruga e drejtë, atëherë ajo do të rrisë fëmijë të devijuar, sepse lidhja që kanë fëmijët me nënën qëndron mbi çdo lidhje tjetër. Për sa kohë që do të jetë nën kujdesin e nënës, çdo gjë që fëmija mendon dhe mëson, do ta marrë prej saj. Fjala e nënës, morali dhe veprimet e saj kanë një ndikim të madh tek

⁴⁶ Nga një bisedë rreth rolit të nënave, më datë 13.5.1979.

⁴⁷ Nga një fjalim rreth rolit të nënave, më datë 13.5.1979.

fëmijët. Ata zhvillohen dhe rriten duke u frymëzuar prej saj.”⁴⁸

Prioriteti i rolit të edukimit

Ky rol i rëndësishëm u paraprin në përgjithësi roleve të tjera. Imam Khomeini e kundërshton angazhimin e gruas në atë formë, që e pengon atë të kryejë këtë rol thelbësor të edukimit. Në lidhje me këtë, ai thotë: “Ju jeni ato gra që morët pjesë në këtë rilindje dhe Allahu ju mbrojti për të kontribuar më tej. Pa dyshim që përgjegjësia juaj më e madhe është edukimi i fëmijëve të mirë e punëmirë.”

“Në ditët e sotme, gratë i kanë larguar nga kujdesi dhe edukimi i fëmijëve të tyre, e për pasojë këta të fundit rriten të kompleksuar. Kujdesuni mirë për fëmijët tuaj! Edukoni ata për të bërë vepra të mira.”⁴⁹

Pra, detyra e gruas është që të luajë rolin e saj hyjnor në familje me kohë të plotë. Punët e tjera të saj nuk duhet ta çenojnë kurrsesi këtë rol.

⁴⁸ Nga një fjalim rreth rolit të nënave, më datë 13.5.1979.

⁴⁹ Nga një bisedë në tubimin e grave në qytetin e Ahvazit, më datë 2.7.1979.

Ky rol ka në thelb përkujdesjen për familjen, edukimin dhe kujdesin për fëmijët: “Edukojini fëmijët tuaj me edukatë islame dhe kujdesuni për ta!”⁵⁰

Edukimi islam përfaqëson shembullin e vlerave më të larta njerëzore: “Gruaja është krijesa e vetme që mund t’i dhurojë shoqërisë individë që sjellin zhvillim dhe që i mundësojnë asaj qëndrimin në rrugën e drejtë dhe në vlerat e larta njerëzore.”

Nëpërmjet gruas arrihet lumturia e shoqërisë në këtë botë dhe në Botën Tjetër: “Përkujdesja e gruas është djepi i të gjitha lumturive, çka do të thotë se vetë ajo është djepi i lumturive.”⁵¹

3- Roli i gruas në shoqëri

“Nuk ka dyshim se zhvillimi apo prishja e një shoqërie lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimin apo prishjen e grave të asaj shoqërie.”⁵²

Gruaja luan një rol të rëndësishëm në shoqëri. Nëse ajo është e mirë dhe e devotshme, atëherë do të ketë një rol pozitiv në zhvillimin e shoqërisë. Ajo do të ngjallë frymën

⁵⁰ Nga një bisedë në një tubim të grave të Dezfulit, më datë 11.6.1979.

⁵¹ Nga fjalimi me rastin e ditës së gruas, më datë 6/5/1979.

⁵² “El Kelimatul Kisaru”, f. 282.

e duhur në shoqëri nëpërmjet mirësisë së mbulimit të saj, ndershmërisë së saj dhe respektimit të ligjeve të sheriatit prej saj.

Nga ana tjetër, nëse gruaja është e shthurur, ajo do të ketë një rol negativ dhe do të çojë në çrregullim të shoqërisë. Kështu pra, roli i saj është shumë delikat. Ajo, ose është një dritë prej dritave hyjnore në shoqëri, ose është një shigjetë prej shigjetave të devijimit, çrregullimit dhe kaosit.

Nisur nga kjo, Islami nuk dëshiron mënjanimin e gruas në shoqëri; përkundrazi, ai e nxit atë që të japë kontribut dhe e konsideron si një dritë prej dritave të mirësisë. Në Islam, gratë kanë një rol me peshë në ndërtimin e shoqërisë, prandaj edhe kanë një pozitë të lartë.

“Islami nuk i shkëput gratë nga fushat e jetës shoqërore, por i mirëpret ato që të lartësohen në shoqëri. Vërtet, ne i mirëpresim arritjet që ka kryer bota perëndimore, por jo shthurjen me të cilën ata kanë matufosur vetet e tyre.”⁵³

“Nën udhëheqjen islame, gruaja mund të marrë pjesë aktive, bashkë me burrat, në ndërtimin e shoqërisë.”⁵⁴

⁵³ Nga një takim me gazetën gjermane të botës së tretë, më datë 5.11.1978.

⁵⁴ “El Kelimatul Kisar”, f. 283.

Pra, gruaja ka një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore, por ajo duhet të jetë e mbrojtur dhe të ruajë nderin e saj në publik.

Duke folur mbi këtë rol të rëndësishëm të gruas, Imam Khomeini thotë: “Sot, gratë duhet të luajnë rolin e tyre shoqëror dhe të marrin përgjegjësitë e tyre fetare, duke ruajtur thjeshtësinë në publik.”⁵⁵

4- Roli i gruas në politikë dhe në ndërtimin e shoqërisë

Imam Khomeini e ka përmendur domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së gruas në çështjet politike, në ndërtimin e sistemit dhe të organizmave të tij efektive në të gjitha fushat. Disa prej këtyre fushave janë:

a- Pjesëmarrja në dhënien e opinionëve për çështjet që kanë të bëjnë me ligjin islam (Sheriatin), pjesëmarrja në procesin e zgjedhjeve, si dhe në kandidim

“Një prej çështjeve të rëndësishme është pjesëmarrja e grave të virtytshme dhe guximtare në të gjitha fushat,

⁵⁵ Nga një bisedë në Konferencën e Gruas, më datë 10.9.1980.

duke ofruar mendimet dhe qasjet e tyre për çështje që kanë të bëjnë me ligjin islam.”⁵⁶

Gratë gëzojnë të drejtën e zgjedhjes, dhe ne besojmë vërtet tek këto të drejta më shumë sesa perëndimorët. Ato gëzojnë të drejtën e mendimit, të drejtën e zgjedhjes dhe të drejtën e kandidimit.”⁵⁷

Gruaja ka të drejtën e zgjedhjes, duke zgjedhur personin që ajo e mendon si të përshtatshëm. Po kështu, ajo ka të drejtën e kandidimit, ku i mundësohet të zgjidhet si kandidate, sikurse mundet që të “pushtojë” qendrën e qytetit dhe të bëjë punën e saj nëse njerëzit e zgjedhin, pa bërë asnjë dallim mes saj dhe burrit.

b- Diskutimi për çështjet politike

Çështjet dhe punët politike nuk janë specifike vetëm për burrat. Përkundrazi, edhe gruaja luan rolin e saj të rëndësishëm në to. Imam Khomeini mendon se është e domosdoshme që gruaja të kontribuojë në çështjet politike. Duke folur për këtë, ai thotë:

“Ashtu sikurse burrat japin kontributin e tyre në çështjet politike dhe në mbrojtjen e shoqërisë, po ashtu edhe gratë duhet të jenë aktive dhe të kujdesen për

⁵⁶ Nga një fjalim në kuadrin e kërkimit të mendimit juridik, më datë 24.3.1979.

⁵⁷ Nga një bisedë në një kuvend me popullin, më datë 29.3.1979.

shoqërinë. Ato duhet të marrin pjesë në aktivitetet sociale dhe politike në mënyrë të barabartë me burrat, sigurisht duke u kujdesur për çështjet që ka urdhëruar Islami.”⁵⁸

c- Ngritja dhe popullimi i qyteteve

Gratë janë pjesë e rëndësishme e një vendi. Ato përfitojnë nga mirësitë dhe potencialet e tij si dhe dëmtohen nga mangësitë dhe problemet që ekzistojnë brenda tij. Ato marrin përsipër përgjegjësinë e ngritjes së qyteteve sikurse edhe burrat. Duke folur për këtë, Imam Khomeini thotë: “Sot, gratë në vendin tonë qëndrojnë përkrah burrave në ngritjen dhe popullimin e qyteteve.”⁵⁹

d- Menaxhimi i qyteteve

Gruaja nuk është thjesht një nxitëse e punës, apo zbatuese e urdhëresave, por ajo duhet të ndihmojë edhe në menaxhimin e vendeve e të angazhohet në poste të larta qeverisëse. Kështu, gjinia e saj nuk e privon atë që të jetë aktive dhe të ketë poste drejtuese. Imam Khomeni thotë: “Cili është ai, që i ka përgatitur dhe i ka nxitur këto gra, për të marrë pjesë në drejtimin dhe qeverisjen e vendeve? Cili është ai që e ka bërë këtë? Allahu i Madhëruar është Ai

⁵⁸ Nga një bisedë në tubimin e grave të Kunit, më datë 8.4.1984.

⁵⁹ Nga një fjalim me rastin e Ditës së Gruas, më datë 5.5.1980.

që i ka ftuar në këtë! E pa dyshim, këto gra me pjesëmarrjen e tyre, i përgjigjen thirrjes së Allahut!”⁶⁰

5- Lufta dhe veprimtaria ushtarake

Lufta është një nga çështjet që shkakton më tepër pikëpyetje kur bëhet fjalë për gratë. A ka ndonjë rol në luftë ajo? Apo lufta është specifike vetëm për burrat? Nëse gruaja ka ndonjë rol, atëherë cili është ai?

a- Pjesëmarrja në luftëra

Islami ka bërë dallimin midis luftërave të zakonshme dhe atyre mbrojtëse. Në luftërat e zakonshme, pjesëmarrja nuk është obligim për gruan, ndërsa në luftërat mbrojtëse, mbrojtja është obligim si për burrin, ashtu edhe për gruan, pa dallim.

Imam Khomeni thotë: “Lufta nuk është detyrim për gratë, por mbrojtja është detyrim për çdo individ sipas aftësisë dhe mundësisë.”⁶¹

Nëse ndodh ndonjë sulm kundër një vendi mysliman, atëherë është detyrë dhe obligim i të gjithë qytetarëve të atij vendi, burra dhe gra, që të ngrihen për ta mbrojtur. Pa dyshim se mbrojtja nuk kufizohet vetëm te

⁶⁰ Nga një bisedë në tubimin e anëtarëve të Lidhjes së Grave, më datë 27.12.1980.

⁶¹ “El Istiftaatu”, vëll.1, f. 503.

burrat duke lënë mënjanë gratë apo duke veçuar një grup ndaj një tjetri; përkundrazi, të gjithë duhet të lëvizin dhe ta mbrojnë vendin.”⁶²

Luftërat me të cilat përballet bota islame sot, e kanë pozicionuar atë në një situatë mbrojtjeje. Kështu, lufta në këto vende është një nga dëshmitë më të qarta të luftës mbrojtëse dhe prej saj nuk përjashtohet asnjë, as burrat dhe as gratë.

“Vëllezër dhe motra të nderuara, në çdo skaj të botës qofshi, mbrojeni identitetin tuaj islam dhe kombëtar! Mbroni vetet tuaja pa asnjë frikë dhe asnjë rezervë përballë armiqve tuaj! Mbrojini popujt dhe vendet islame!”⁶³

b- Pjesëmarrja në stërvitjen ushtarake

Kur flasim për ndonjë veprimtari ushtarake që mund të kryejë gruaja, sidomos në situatën e mbrojtjes, është normale që të pranojmë domosdoshmërinë e stërvitjes ushtarake. Pra, stërvitja është pararojë e domosdoshme e çdo veprimtarie ushtarake. Kjo gjë bëhet në zbatim të thirrjes së Allahut të Lartësuar, i Cili thotë: **“dhe ju përgatituni me fuqi ushtarake...”**

⁶² Nga një fjalim në tubimin e anëtarëve të Institutit Islam të Luftës kundër Narkotizmit, më datë 27.12.1979.

⁶³ Nga një fjalë e shkëputur ndaj haxhilerëve të Qabes, më datë 29.9.1979.

Në një nga fjalimet e tij, Imam Khomeni ka thënë: “Nëse mbrojtja është një obligim për të gjithë, atëherë duhet të bëhen edhe përgatitjet për të. Njëra prej tyre është stërvitja ushtarake dhe të mësuarit e arteve të luftimit për atë që nuk di. Pra, duhet patjetër të mësojmë se si të mbrohemi. Sigurisht, mjedisi ku ju praktikoheni në artet ushtarake duhet që të jetë një mjedis i shëndoshë dhe i pastër, një mjedis islam, ku të ruhet me kujdes etika islame.”⁶⁴

“Jam shpresëplotë për atë që është arritur deri më tani. Vendosmëria dhe ambicia e burrave dhe grave të nderuara, si dhe përmbushja me sukses e roleve të tyre në të gjitha fushat, janë dëshmi e përparimit dhe e zhvillimit të ymetit islam.”⁶⁵

⁶⁴ Nga një fjalim me rastin e Ditës së Gruas, më datë 10.2.1986.

⁶⁵ Nga një fjalim me rastin e javës së mobilizimit të njerëzve të dobët, më datë 20.2.1980.

PJESA E KATËRT

Kontributi i gruas bashkëkohore

Gruaja e përgjegjshme myslimane ka mundur të zbatojë rolin e saj shoqëror, kulturor dhe politik dhe ka dëshmuar se ajo është e denjë për të bartur përgjegjësinë që i është dhënë në të gjitha fushat.

Imam Khomeini ka shprehur konsiderata të larta për gruan myslimane, ka përmendur rolet e shumta me të cilat është sfiduar ajo, e që i ka përmbushur me sukses. Ndër këto role do të përmendim:

Roli i gruas në triumfin e Revolucionit Islamik

Gruaja myslimane ka luajtur një rol thelbësor në ringjalljen dhe progresin islam. Ajo e ka mbështetur këtë ringjallje me të gjitha forcat e saj, derisa ka arritur triumfin.

Duke folur në lidhje me këtë, Imam Khomeni ka thënë: “Ju, të nderuara gra heroina, keni qenë dhe vazhdoni të jeni në ballë të këtij triumfi.”⁶⁶

Gjatë konfrontimit, gruaja nuk ka qenë në pozicionet e prapavijës; përkundrazi, ajo ka qenë gjithmonë në pararojë: “Ju, të nderuara gra, keni dëshmuar se jeni gjithmonë në radhët e pararojës dhe se jeni triumfuese ndaj burrave, kurse burrat frymëzohen në vendosmërinë e tyre prej jush.”⁶⁷

“Këtë triumf që kemi arritur ua kemi borxh si fillim përpjekjeve dhe mundimit të grave, e pastaj atyre të burrave, pasi gratë kanë qenë në ballë të radhëve e në pararojë.”⁶⁸

Gruaja nuk u mjaftua vetëm me këtë rol të drejtpërdrejtë, por mbështeti edhe burrin, në mënyrë që ai të luante rolin e tij në këtë ringjallje dhe zhvillim: “Ringjalljen dhe zhvillimin tonë ua kemi borxh grave. Burrat dilnin në rrugë duke ndjekur shembullin e grave, dhe këto të fundit i mbështesnin burrat duke qëndruar në

⁶⁶ Në një fjalim nga tubimi i anëtarëve të Kuvendit të Këshillimit, më datë 19.3.1981.

⁶⁷ Nga një fjalim në tubimin e grave në Kum, më datë 6.3.1979.

⁶⁸ Nga një fjalim në tubimin e grave në Kum, më datë 6.3.1979.

ballë të progresit. Vërtet, këto gra kanë triumfuar ndaj fuqisë së madhe djallëzore!”⁶⁹

I gjithë ky angazhim nuk është në kundërshtim me modestinë e gruas myslimane; përkundrazi, Islami e mbështet lëvizjen e gruas dhe përparimin e saj.

Roli i gruas në luftë dhe në mbështetjen e fronteve të saj

“Kur i shoh në televizion gratë e nderuara, të cilat kontribuojnë në ndihmë të ushtrisë dhe në mbështetje të forcave të armatosura, ndiej një respekt dhe një konsideratë të atillë, që nuk i ndiej për askënd tjetër. Këto gra bëjnë gjithçka, duke mos pritur asnjë shpërblim prej ndokujt. Vërtet, ato janë ushtarë të panjohura në frontet e luftës, madje të përkushtuara tërësisht në të.”⁷⁰

⁶⁹ Nga një fjalim në tubimin e studentëve të universiteteve, më datë 12.4.1979.

⁷⁰ Nga një thirrje për popullin iranian, më datë 22.1.1978.

Pozita e lartë e vajzës që martohet me një të plagosur

“Sakrificat e grave në luftë janë të shumta e s’ mund të përshkruhen dot me fjalë. Gjatë kësaj lufte kam parë situata të atilla të nënave, motrave, bashkëshorteve dhe vejushave, që nuk i kam parë në asnjë rast tjetër. Ato janë përkujtime që nuk harrohen.

Më ka lënë mbresa në mënyrë të veçantë, martesat e një vajze të re me një nga mbështetësit guximtarë të Revolucionit, i cili i ka humbur në luftë të dyja duart dhe sytë i janë shuar. Kjo vajzë fliste e emocionuar, plot sinqeritet dhe çiltërsi, e thoshte: Meqenëse nuk munda të isha në front të luftës, shpresoj që me këtë martesë të marr shpërblimin sikur ia kam shlyer borxhin tim Revolucionit dhe Islamit.

Vërtet, ndaj kësaj deklaratë të sinqertë si dhe pozitës së lartë të saj, mbesin të heshtur shkrimtarët, poetët, elokuentët, piktorët, artistët, psikologët, filozofët dhe jurisprudentët. Me atë që bën, kjo vajzë është në kërkim të kënaqësisë së Allahut.”⁷¹

⁷¹ Nga një fjalim në tubimin e studentëve, më datë 3.11.1980.

Roli i gruas në industri dhe bujqësi

Gruaja myslimane ka pasur dhe ka edhe role të tjera në ndërtimin e shoqërisë.

Duke folur në lidhje me këto role, Imam Khomeini thotë: “Sot, gratë myslimane ushtrojnë aktivitetet e tyre në të gjitha fushat, si kulturore ashtu edhe ekonomike. Një pjesë e madhe e tyre punojnë në bujqësi, një pjesë në industri e një pjesë tjetër e ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e kulturës, arsimit dhe të artit. Të gjitha këto përpjekje dhe angazhime janë të lavdëruara tek Allahu i Madhëruar dhe janë nën kujdesin e mbrojtjen e Tij.”⁷²

Ndihmat financiare për njerëzit në nevojë

Gruaja myslimane ka pasur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e njerëzve në nevojë: “Gratë myslimane përfaqësojnë modelin e mirësjelljes dhe të modestisë, duke qenë pararojë në progres. Ato u kanë dhuruar stolitë e tyre njerëzve të dobët e në nevojë.”⁷³

Madje, ka raste kur gratë myslimane kanë dhënë të gjitha kursimet e tyre për njerëzit në nevojë, apo për t'u

⁷² Nga një fjalim me rastin e Ditës së Gruas, më datë 14.4.1982.

⁷³ Nga një fjalim me rastin e Ditës së Gruas, më datë 12.3.1985.

ndërtuar shtëpi të varfërve: “Shumë gra kanë ardhur për të dorëzuar atë çfarë kanë kursyer për njerëzit në nevojë, apo për t’u ndërtuar të varfërve shtëpi.”⁷⁴

Roli i gruas në arsim

Arsimi është një nga fushat ku gruaja e ka luajtur rolin e saj në mënyrën më të përsosur. Këtë gjë e vë në dukje edhe Imam Khomeini, i cili thotë: “Gratë, të cilat më parë kanë qenë të privuara nga çdo gjë në shoqëri, këto vitet e fundit kanë përparuar në një mënyrë të atillë, që të bën të ndihesh krenar, dhe e gjitha kjo duke ruajtur njëkohësisht edhe ekuilibrat e sheriatit. Sot, ato vazhdojnë aktivitetin e tyre në studime, mësimdhënie dhe kumtime.”⁷⁵

Roli i gruas në planifikim

Roli i gruas u shtri më tej edhe në planifikim si dhe në shpалosjen e mendimit dhe të kritikës konstruktive: “Motrat tona, të cilat më parë kanë qenë të angazhuara me çështje të tjera, sot nuk kanë shqetësim më të madh sesa të

⁷⁴ Nga një fjalim në tubimin e grave, më datë 17.5.1979.

⁷⁵ Nga një fjalim në tubimin e studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, më datë 21.5.1979.

menduarit rreth fatit të popullit dhe vendit të tyre, krah për krah burrave, ku ato kontribuojnë me programe e projekte, duke debatuar dhe diskutuar. Sigurisht që këtë ndryshim e mundësoi Allahu i Lartësuar, Ai që i rrotullon dhe që i kthen zemrat.”⁷⁶

Vendosmëria e gruas së përgjegjshme të kohës së sotme

Gratë vigjilente e kanë dëshmuar me fakte se nuk kanë devijuar drejt rrugës qorre dhe të humbur, e as nuk kanë rënë në kurthet e ulëta të qëllimkëqinjve.

Pavarësisht përhapjes së të keqes ndërmjet shoqërive si dhe çdo lloj propagande të bërë për t’i çuar në devijim, gratë ia dolën për t’i paraprirë shoqërisë dhe për t’i treguar të gjithë botës modelin e gruas së shëndoshë, të pastër, të drejtuar në rrugë të drejtë, e cila luan një rol pozitiv aktiv në shoqëri.

⁷⁶ Nga një fjalim me imamët e xhamive të zonës së Kejlanit, më datë 13.1.1982.

Mbyllje

“Ju gra dhe motra të nderuara duhet të jeni të zgjuara dhe vigjilente, e të mos lejoni që gjaku i dëshmorëve të shkojë kot. Çlirohuni nga pasionet dhe largoni nga vetet tuaja problemet dhe shqetësimet personale.”⁷⁷

⁷⁷ Nga një fjalim në tubimin e grave, më datë 16.3.1981.

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	6
Pjesa e parë: Pozita e gruas.....	8
Mëkëmbësi i Allahut.....	8
Dita e Gruas.....	11
Si e ka prezantuar Islami gruan?.....	13
Vajza është shumë e mirë.....	16
Pjesa e dytë: Midis të drejtave dhe përsosmërisë.....	17
Gruaja është një qenie njerëzore, dhe jo një mall për t'u shitur.....	17
Liria e gruas.....	18
Çfarë është liria?.....	19
Ndalimi i mbulesës është një model i lirisë së tyre.....	22
Liria jote mbaron aty ku prek të drejtat e të tjerëve.....	24
Të drejtat e gruas.....	25
Gruaja dhe puna.....	27
Barazia.....	28
Arsimi.....	30
Gruaja në rrethet shkencore	33
Pjesa e tretë: Roli i gruas në ndërtimin e shoqërisë.....	34
Gruaja është një pjesë e rëndësishme e shoqërisë.....	34
Kontributi në përcaktimin e fateve të vendit.....	36
Kontributi i gruas në familje.....	37

Rëndësia e edukimit.....	38
Prioriteti i rolit të edukimit.....	40
Roli i gruas në shoqëri.....	41
Roli i gruas në politikë dhe në ndërtimin e shoqërisë.....	43
Pjesëmarrja në dhënien e opinionëve për çështjet që kanë të bëjnë me ligjin islam, pjesëmarrja në procesin e zgjedhjeve si dhe në kandidim.....	43
Diskutimi për çështjet politike.....	44
Ngritja dhe popullimi i i qyteteve.....	45
Menaxhimi i çështjeve të qyteteve.....	45
Lufta dhe veprimtaria ushtarake.....	46
Pjesëmarrja në luftëra.....	46
Pjesëmarrja në stërvitjen ushtarake.....	47
Pjesa e katërt: Kontributi i gruas bashkëkohore.....	49
Roli i gruas në triumfin e Revolucionit Islamik.....	49
Roli i gruas në luftë dhe në mbështetjen e fronteve të saj.....	51
Pozita e lartë e vajzës që martohet me një të plagosur.....	52
Roli i gruas në industri dhe bujqësi.....	53
Ndihmat financiare për njerëzit në nevojë.....	53
Roli i gruas në arsim.....	54
Roli i gruas në planifikim.....	54
Vendosmëria e gruas së përgjegjshme të kohës së sotme.....	55
Mbyllje.....	56

المرأة في فكر الإمام خميني

تيرانا 2018

اسم الكتاب: المرأة في فكر الإمام خميني

المترجم: الحاج ولنت مريا

التدقيق: صبريه فزا

التصحيح الأدبي: ليسدا راماي

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الايخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا